

NJOFTIM
Nr. 543, datë 26.3.2019

PËR RISHPALLJEN E PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES SË ANËTARIT TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS

Në zbatim të urdhrin të MASR-së nr. 41, datë 24.1.2019, *“Për njoftimin e fillimit të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, mënyrën e vlerësimit të kandidatëve dhe afatin e dorëzimit të dokumentacionit”*, në urdhrin e Rektoratit të Universitetit të Sporteve të Tiranës nr. 9, datë 21.3.2019, *“Për zhvillimin e zgjedhjeve për anëtarë Bordi Administrimi”*, në njoftimin e KIZ-it nr. 2, datë 21.3.2019, *“Kandidatët për anëtarë të Bordit të Administrimit”*, nga ora 9:00 deri në orën 15:00 në zyrën e protokollit të Universitetit të Sporteve të Tiranës rihapen procedurat e përzgjedhjes dhe të vlerësimit për të gjithë të interesuarit që do të aplikojnë në pozicionin e anëtarit të Bordit të Administrimit të UST-së. Afati i dorëzimit të dosjeve është pesë ditë pune pas shpalljes në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Qendrës së Botimeve Zyrtare dhe në Buletinin e Agjencisë së Prokurimit Publik.

Kandidati aplikues duhet të plotësojë kërkesat si më poshtë:

a) Kërkesat e përgjithshme:

- Të jetë shtetas shqiptar.
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
- Të mos ketë marrë masën disiplinore të largimit nga detyra në institucionet ku ka qenë i punësuar më parë.

- Të mos jetë i dënuar penalisht, me vendim gjyqësor të formës së prerë.

b) Kërkesat e veçanta që duhet të plotësojë kandidati:

- Të jetë person me profil publik dhe arritje të shquara brenda apo jashtë vendit në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike dhe juridike. Të ketë të paktën 10 vjet përvojë pune në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike e juridike. Përparësi do të kenë kandidatët me përvojë praktike në sistemin e arsimit të lartë.

- Të ketë integritet etik dhe profesional.

- Të mos jetë i angazhuar në funksione drejtuese partiake.

- Të jetë i padënuar ose ndaj tij të mos jenë dhënë masa sigurie apo dënim me vendim jopërfundimtar për kryerjen e krimeve, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 138/2015, *“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”*, të ndryshuar.

- Të mos ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991, në kuptimin e ligjit *“Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”*.

- Të njohë të paktën një gjuhë të huaj.

- Të mos ketë konflikt interesi në përmbushje të kërkesave dhe dispozitave ligjore.

Lista e dokumentacionit, vendi dhe afati i dorëzimit që kandidati duhet të paraqesë

- Kërkesë për aplikim, ku të jetë specifikuar IAL-i ku kandidon
- Jetëshkrim i plotësuar në gjuhën shqipe (CV - Curriculum Vitae)
- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën “Bachelor”). Për diplomat dhe certifikatat e lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar jashtë Republikës së Shqipërisë, të përcillet Vërtetimi i Njohjes dhe i Njehsimit të Diplomës / Certifikatës të lëshuar nga strukturat përgjegjëse përkatëse

- Fotokopje të librezës së punës

- Fotokopje të letërnjoftimit (ID)

- Vërtetim të gjendjes gjyqësore
- Vërtetim i lëshuar nga gjykata
- Vetëdeklarim mbi mosangazhimin në funksione drejtuese partiake, sipas formatit të shtojcës nr. 1/1
- Vetëdeklarim mbi konfliktin e interesit, sipas formatit të shtojcës nr. 1/2
- Vetëdeklarim për verifikimin e vërtetësisë së dokumenteve të paraqitura nga kandidati, sipas shtojcës nr. 1/3

- Dëshmi e mbrojtjes së gjuhës së huaj

- Vetëdeklarim se nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit, para 2 korrikut 1991, në kuptimin e ligjit *“Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”*

Paraqitja e dokumenteve të cituara më sipër do të bëhet në një nga këto mënyra:

1. Me postë zyrtare në adresë të Universitetit të Sporteve të Tiranës.
2. Dorëzim dorazi në ambientet e zyrës së protokollit në Universitetin e Sporteve të Tiranës.

SHTOJCA nr. 1/1

Vetëdeklarim mbi mosangazhimin në funksione drejtuese partiake

Deklaruesi: _____

Unë, i nënshkruari _____, që po paraqes aplikimin tim për anëtar Bordi Administrimi në institucionet publike të arsimit të lartë, deklaroj se _____ i angazhuar në funksione drejtuese partiake.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklaramit.

Datë _____

Nënshkrimi _____

SHTOJCA nr. 1/2

Vetëdeklarim mbi konfliktin e interesit

Deklaruesi: _____

Unë, i nënshkruari _____, që po paraqes aplikimin tim për anëtar Bordi Administrimi në institucionet publike të arsimit të lartë, deklaroj se _____ në kushtet e konfliktit të interesit që parashikon ligji nr. 9367, datë 7.4.2005, *“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”*, i ndryshuar, dhe legjislacioni në fuqi për të ushtruar këtë detyrë.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklaramit.

Datë _____

Nënshkrimi _____

SHTOJCA nr. 1/3

Vetëdeklarim për verifikimin e vërtetësisë së dokumenteve të paraqitura nga kandidati

Unë, i nënshkruari _____, kandidat në procesin e konkurrimit për anëtar bordi në institucionet publike të arsimit të lartë, autorizoj Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, të verifikoj në çdo kohë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura nga ana ime.

Datë _____

Nënshkrimi _____

REKTOR
Prof. Dr. Agron Cuka